

## KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me date 16.10.2020

**SHITËSI - Znj. Enkeleda Deda**, i lindur më datë 06 Shkurt të vitit 1993 në Shullan, Diber, banues ne Tirane, Shqiperi, i identifikuar me anë të letërnjoftimit nr. **J35206059E**. me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar si Administrator dhe Ortak i Vetem i Shoqërise **“EXXO LITE ” sh.p.k** me 100% te kuotave me **NIPT: L82008014K**

**BLERESI - Z. Cristiano Faloci**, I lindur me 12.11.1967, ne Rome Itali, dhe banuese ne Rome via Stocolma nr 13, Rome Itali, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karte identiteti me numer **Personal: AZ 1416898**

### **BAZA LIGJORE**

#### **Referuar dispozitave ligjore**

- Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”
- Ligji Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” me ndryshimet e mëvonshme
- Kodi Civil
- Akti i Themelimit e Statuti i Shoqërisë
- Data e rregjistrimit eshte 08/08/2018

### **OBJEKTI**

Mbi bazën e ekstraktit të Shoqërisë **“EXXO LITE ” sh.p.k**, shitesi Znj. Enkeleda Deda, është ortak i cili gezon **100,00 % ta kapitalit te shoqerise me numer pjesesh 1,00 dhe vlere kapitali 700.000,00**

Mbi bazën e dokumentave të sipërcituar, përpilojmë këtë kontratë shitje kuotash me objekt:

- **Shitesi** i shet bleresit 100 % të kuotave që zotëron në **Shoqërine “EXXO LITE ” sh.p.k**, kundrejt vlerës totale 700.000,00 Leke (shtate qind mije leke) ,likujdimi i së cilës do të realizohet në rrugët e parashikuara në ligj në një moment të dytë pas nënshkrimit të kësaj kontrate që do të përcaktohet me mirëkuptim. Ne momentin e neshkrimit te Kontrates Pala blerese merr persiper te gjithë detyrimet qe ka pala shitesë ndaj institucioneve shteterore ose ndaj institucioneve private ose individeve . Palët bien dakort që ky ndryshim të pasqyrohet në QKB pasi kontrata e shitjes se kuotave te regjistrohet ne QKB.

Me hartimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate **Znj. Enkeleda Deda** zhvishet nga pronësia si dhe detyrimeve ndaj institucioneve shtetërore ose ndaj institucioneve private ose individeve dhe deklaron se heq dorë nga çdo e drejtë për të kërkuar përfitime të çdo lloji për këtë sasi kuotash, po kështu heq dorë përfundimisht nga çdo pretendim mbi dividendet dhe çdo përfitim tjetër nga aktiviteti i shoqërisë në një masë prej 100 % duke pranuar këtë transaksion.

Ndarje e re e dividendit do të bëhet në masën 100 % per **Z. Cristiano Faloci, i cili do te jete Ortak dhe Administrator i Vetem i shoqerise "EXXO LITE "shpk.**

- Mbas nënshkrimit të këtij Akti e pasqyrimit të QKB Shoqëria pëson këto ndryshime:

### **Ishte:**

1. Shoqëria **"EXXO LITE " sh.p.k** shpk me Ortakë: **Znj. Enkeleda Deda** eshte zotësues i 100% të kapitalit në Shoqërisë **"EXXO LITE " sh.p.k.**

### **Bëhet:**

Në bazë të vendimit, Ortak dhe Administrator i vetem i Shoqërisë **"EXXO LITE " sh.p.k** do te jete **Z. Cristiano Faloci**, lindur 12.11.1967, ne Rome Itali, dhe banuese ne Rome via Stoccolma nr 13, Rome Itali, identifikuar me karte identiteti me numer **Personal: AZ 1416898**, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar me 100% te kapitalit te Shoqerise me vlere nominale te barabarte me 700.000,00 Leke.

**SHITËSI**

**Znj. Enkeleda Deda**



**BLERËSI**

**Z. Cristiano Faloci**

Faloci Cristiano